



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU



Prishtinë, 10 korrik 2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1170\_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 25 dhe Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V\_402\_2012 të datës 15 qershor 2012 lëshuar shoqërisë "Kelkos Energy" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC "Bellaja me kapacitet të instaluar prej 8.06 MW, dhe HC Deçan me kapacitet të instaluar prej 9.8 MW, në Lumin lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit; dhe
- Shkresën e datës 26.06.2019 të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës,
- Kërkesën e shoqërisë KelKos Energy SH.P.K., nr. prot. 371/19 të datës 28.06.2019 për shtyrjen e afatit të dhënë me Vendimin V\_1120\_2019 të datës 28 mars 2019, për kompletimin e kërkesave sipas legjislacionit në fuqi.

në seancën e mbajtur me datë 10 korrik 2019 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET**- kërkesa e shoqëria KelKos Energy SH.P.K. dhe **SHTYHET** afati i Vendimit V\_1120\_2019 i datës 28 mars 2019 edhe për nëntëdhjetë **(90) ditë, nga data e lëshimit të këtij Vendimi**, për kompletimin dhe pajisjen me Certifikatë të Përdorimit dhe Leje Mjedisore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për Hidrocentralin **HC Belaja** me kapacitet të instaluar prej 8.06 MW dhe **HC Deçan** me kapacitet të instaluar prej 9.8 MW, dhe brenda këtij afati të njëjtat ti dorëzon në ZRRE, në mënyrë që të pajiset me Licencë të prodhimit të energjisë elektrike.
- II. Shoqëria KelKos Energy SH.P.K., me Vendimin për Lëshimin e Autorizimit Final V\_402\_2012 të datës 15 qershor 2012 është autorizuar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentralet në lumin Lumëbardhi i Deçanit, HC Bellaja me kapacitet të instaluar prej 8.06 MW dhe HC Deçan me kapacitet të instaluar prej 9.8 MW, Komuna e Deçanit, pas plotësimit të dëshmimeve administrative, teknike, ndërtimore dhe të mjedisit.
- III. ZRRE do të ndërmarrë veprimet ligjore për ndërprerjen e prodhimit dhe shkyçjen e gjeneratorëve HC Belaja dhe HC Deçan nga Rrjeti i Transmetimit, në rast se nuk plotësohen kushtet sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij vendimi.
- IV. Bordi i ZRRE-së, sa i përket kërkesës për Hidrocentralin HC Lumëbardhi II. me kapacitet 6.2 MW, ka vendosur që Vendimi V 1121 2019 i datës 29 mars 2019 të mbetet në fuqi i pa ndryshuar përderisa të pajiset me Leje të Përdorimit nga MMPH.



## Arsyetim

- ZRRE me datë 09.08.2010 nga shoqëria “**Kelkos Energy**” SH.P.K., ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, për HC “Bellaja me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, HC “Deçan” me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW dhe HC “Lumëbardhi” 5.5 MW, Lokacioni lumi Lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit.
- ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, me datë 11 nëntor 2010 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_296\_2010, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t’i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- ZRRE me datë 15 qershor 2013 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V\_402\_2012 shoqërisë “**Kelkos Energy**” Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC “Bellaja” me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, dhe HC “Deçan” me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW Lokacioni lumi Lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit.
- ZRRE me datë 19.05.2016 ka lëshuar Vendimin V\_813\_2016 për Modifikimin e Autorizimit Final V\_402\_2012 për HC “Bellaja” me kapacitet të instaluar prej 8.06 MW, dhe HC “Deçan” me kapacitet të instaluar prej 9.8 MW Lokacioni lumi Lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit, sipas vendimit Nr. 1287/16 –ZSP -356 DU/16 për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1839/11 –ZSP-69/12, të datës 09.02.2012, për HC “Bellaja”, të lëshuar nga MMPH, të datës 24.03.2016 dhe vendimin Nr. 1287/16 –ZSP -355 DU/16 për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1839/11 –ZSP-69/12, të datës 09.02.2012, për HC Deçan, të lëshuar nga MMPH, të datës 24.03.2016.
- ZRRE me datë 24.02.2016, nga shoqëria KelKos Energy SH.P.K., ka pranuar kërkesën për marrjen e Licencës për Prodhimin të Energjisë Elektrike, dhe pas vlerësimit të aplikacionit ka vlerësuar se mungon Leja Mjedisore e lëshuar nga MMPH, dhe nga ajo kohë e deri më tani është në pritje të sjellës së Lejes Mjedisore nga aplikuesi, në mënyrë që të lëshohet edhe licenca formale sipas Rregullës për Licencim të ZRRE-së.
- ZRRE me datë 19.12.2018 iu ka drejtuar me shkrim MMPH-së, për të kërkuar sqarime në lidhje me lëndët që janë në shqyrtim në ZRRE, se a janë pajisur me Leje Mjedisore gjeneratorët e BRE-ve.
- ZRRE me datë 22.01.2019 nga MMPH ka pranuar njoftimin Nr. 7374/18, përmes së cilës është njoftuar se citoj “*Kompania KelKos Energy SH.P.K., deri më tani nuk ka bërë kërkesë për tu pajisur me Leje Mjedisore, për prodhimin e energjisë elektrike nga HC Belaja , HC Deçan dhe HC Lumëbardhi II*”.
- ZRRE me datë 01.03.2019 nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar “Informatë për ZRRE”, me të cilën ka njoftuar se citoj “ *Operatori ekonomik “KelKos Energy” SH.P.K., nuk ka përfunduar të gjitha procedurat administrative – ligjore pranë MMPH-së, për projektin “ Ndërtimin e Hidrocentraleve në Lumëbardhë të Deçanit, dhe si rrjedhojë nuk janë plotësuar kriteret ligjore për operim”*






- MMPH, në shkresën e saj ka theksuar se përgjatë ndërtimit të HC-ve, janë përcjellur në vazhdimësi punimet nga Inspektorati i MMPH, dhe ka sqaruar se kompania KelKos Energy SH.P.K., nuk është pajisur me Leje të Përdorimit dhe Leje Mjedisore nga MMPH, për shkak se nuk ka pasur aplikime nga investitori dhe si rrjedhojë nuk janë kryer pikat 5 dhe 6 të “Informatës për ZRRE”.
  - ZRRE me datë 26.06.2019 nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar “Konfirmim”, me të cilën ka njoftuar se citoj “ Kompania “KelKos Energy” SH.P.K.-Kosovë, ka aplikuar pranë MMPH-ës, për leje të përdorimit për 2 (dy) Hidrocentralet në Kaskadën e Lumëbardhit të Deçanit, “Hidrocentralin Deçani” dhe “Hidrocentralin Belaja”, me datën 24.06.2019 sipas nr. të prot. 3968/19 si dhe ka aplikuar për Leje të përdorimit edhe për “Hidrocentralin Lumëbardhin II.” me datën 26.06.2019 sipas nr. prot. 4008/19”
  - MMPH në shkresën e saj, ka sqaruar se citoj” Dokumentacioni i dorëzuar është duke u trajtuar nga Departamenti i Planifikimit Hapësinor Ndërtimit dhe Banimi i cili është kompetent për lëshimin e lejes së përdorimit, andaj ju njoftojmë se trajtimi i këtyre aplikacioneve të lejeve të përdorimit kërkon kohë dhe angazhim profesional të resurseve të MMPH-së, dhe Resurseve profesionale nga jashtë për të përgatitur raportin final të këtyre projekteve.
  - Poashtu MMPH në shkresën e saj citoj ”bazuar në procedurat e parapara me ligj ne do të përgatisim lejet e përdorimit për këto projekte-hidrocentrale dhe në momentin e lëshimit të tyre ne do t’iu informojmë juve”.
  - Shoqëria “KelKos Energy” SH.P.K., në kërkesën e saj karkuar, që Bordi i ZRRE-së, të vazhdoj afatin e kompletimit të lejeve të përdorimit për HC Belaja dhe HC Deçan, duke iu referuar vendimit V\_1120\_2019 të datës 28 mars 2019 i cili ka vlejtur deri me 28 qershor 2019.
  - Shoqëria “KelKos Energy” SH.P.K., poashtu ka kërkuar që të ndysohet dhe lehtësohet vendimi V\_1121\_2019 lidhur me ndërprerjen e prodhimit HC Lumëbardhi II.
  - Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha shkresave dhe kërkesave të MMPH, ka vendosur se, për HC Belaja me kapacitet 8.06 MW dhe HC Deçan me kapacitet 9.8 MW të shtyhet afati edhe nëntëdhjetë **(90) ditë për kompletimin dhe** pajisjen me Certifikatë të Përdorimit dhe Leje Mjedisore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).
  - Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha shkresave dhe kërkesave të MMPH, ka vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.
- V.** Shoqëria “Kelkos Energy” SH.P.K., duhet të pajiset me Leje të Përdorimit dhe Leje Mjedisore nga MMPH, brenda afatit të përcaktuar në dispozitivin nën pikën I. të këtij vendimi.
- VI.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VII.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejrija, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KelKos Energy SH.P.K.,
- KOSTT-it,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.